



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 604, datë 04.12.2020

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}

**PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 04.12.2020 pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magjistrat (profili gjyqtar), në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin kandidatës znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} është candidate për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 19.06.2020, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, u përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr.22, datë 16.07.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.492 prot., datë 17.07.2020 (protokolluar me nr. 3383 prot., datë 17.07.2020).

2. Me Vendimin nr.257, datë 20.07.2020, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.

3. Më datë 20.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktin telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 20.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidatja, znj. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 257, datë 20.07.02020, që ishte data 04.08.2020 (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 28.07.2020 bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 28.07.2019, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidatja në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e saj në punë (punësimin), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidates, znj. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

10. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidaten znj. {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30 (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 19.06.2020, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidaten {...}.

11. Gjithsesi, për kandidaten {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

11.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2020), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (19 Qershor 2020), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimin (Shtator 2020). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimin në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

11.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)¹, pika 4, shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

12. Konkretisht, për kandidaten u verifikua:

¹ 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshirohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:

a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;

b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

a) pasja nga ajo e zotësisë së plotë për të vepruar, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) pasja e shtetësisë shqiptare, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti letër njoftim , lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 10.05.2011, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 04.09.2020, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) gjendja gjyqësore, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), duke printuar në letër Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 datë 20.02.2020, ndërsa gjatë verifikimit, në kuadër edhe të verifikimit të figurës së kandidates, u administruan Shkresa nr.7733/1 prot., datë 30.07.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) disiplina në punë, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës janë depozituar Vërtetim nr. 1093 prot., datë 14.02.2020 nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.3725/1 prot., datë 05.08.2020 e Gjykatës së Apelit Tiranë. Letër reference datë 17.02.2020 dhe Vërtetim nr. 24/2 prot., datë 24.02.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.4964/1 prot., datë 07.08.2020 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu u administrua shkresa nr.07626/1 prot., datë 07.08.2020 e Shërbimit Përmbarimor FS shpk (dikur shërbimi përmbarimor STAR). Për këtë kandidate u administrua shkresa nr.02417/1 prot., datë 06.08.2020 e subjektit “ADCA” shpk (si pjesë përbërëse dhe shoqëria “Shërbimi përmbarimor ZIG”). Sipas dokumenteve kandidatja nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) qenia bashkëpunëtore, informatorë, ose agjente i shërbimeve sekrete, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.02.2020 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidates bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

12.1. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) pasja e kriterit arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Diplomë në Drejtësi”, me nr.12809, datë 29.07.2011, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Listë

Notash më datë 09.09.2011, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Është depozituar dokumenti “Diplomë Master i Shkencave në drejtë Penale”, me nr.124, datë 03.04.2014, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Listë Notash më datë 29.10.2013, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

b) pasja e përvojës profesionale, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Punë”, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 1542/9 prot., datë 07.08.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shkresa nr. 4410/1 prot., datë 05.08.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtyre dokumenteve, kandidatja ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike dhe privat, konkretisht si “sekretare gjyqësore” pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

c) anëtarësia në parti politike, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.02.2020 në të cilën deklaroi se nuk është anëtare e ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatës anëtare e ndonjë partie politike;

ç) qenia anëtare, bashkëpunëtorë ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.02.2020 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ndërkohë që për vetë moshën e saj (i datëlindjes 10.11.1989) ajo nuk mund të ketë qenë i tillë;

B. Për kriterin e pasurisë

13. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 280/23 prot., datë 29.09.2020.

14.1 Sipas këtij Raporti ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

14.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten :

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

15.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni i dërgua me Shkresën nr. 15042/9 prot., datë 07.08.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepen të gjitha të dhëna për aktivitete tregtare.

15.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 14353/1 prot., datë 10.08.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

16. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

17. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidatja të pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

18. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

19. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së

fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit², ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni³.

20. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatës {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitet të kundërligjshme.

21. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...} asaj iu kërkua dhe ajo plotësoi dhe depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 22.07.2020, formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

22. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1166/36 prot., datë 28.09.2020, përgjigjet zyrtare të 29 (njëzetënëntë) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, apelit si dhe përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezultoi se për kandidaten {...}, nuk është regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jo përfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

23. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5543/1 prot., datë 01.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.3631/1, datë 02.10.2020, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

24. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, konkretisht në lidhje me përbërësit e gjendjes civile, ndërsa rezultonte të kishte *ndryshuar mbiemrin nga “Pjetëri në “{...}”, më datë 10.01.2006*. Për pasojë, është vlerësuar se kishte vend për verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

² Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

³ Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

24.1 Në përgjigje të kërkesës së Këshillit për verifikim të thelluar, Prokuroria e Përgjithshme, me Shkresën nr. 1166/231 prot., datë 18.11.2020, ka përcjellë Vendimin e Drejtorisë së Kordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin {...} Petrit {...}”. Sipas këtij vendimi, pas kryerjes së verifikimeve të thelluara, është vendosur ndër të tjera se :

“..Omissis. Referuar përgjigjes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nr. 658/1, datë 04.11.2020, konstatohet se më datë 10.01.2006, anëtarët e familjes së shtetases {...}, kanë ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e mbiemrit “PJETËRI” në “{...}”.

Nuk rezultoi e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë vepre penale, nga autoritetet gjyqësore shqiptare;

Nuk rezultoi e dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim të formës së prerë;

Nuk rezultoi të ketë qenë e ndaluar apo e arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një vepre penale;

Nuk rezultoi të ketë qenë e siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale nga një autoritet shqiptar..”;

24.2 Rezultatet e verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme u shqyrtuan nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila, bazuar në të dhënat e grumbulluara edhe gjatë verifikimit të thelluar, përmes Shkresës nr. 4839 prot., datë 23.11.2020, informon se kandidatja: “- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 22.7.2020; - nga struktura e posaçme formulari është numërtuar me numrin rendor 000503; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigja e ardhur nga Drejtoria e Shërbimit të Gjendjes Civile ka rezultuar ndryshime në të dhënat e gjendjes civile në raport me ato të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, konkretisht nuk ka deklaruar ndryshimin, familjarisht, më datë 10.01.2006, të përbërësit të gjendjes civile - mbiemrit - nga “Pjetëri” në “{...}”; - për shkak të ndryshimeve të konstatuara në të dhënat e gjendjes civile në raport me ato të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, është kërkuar verifikim i thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme; - nga verifikimi i thelluar prej Prokurorisë së Përgjithshme, për kandidaten nuk kanë rezultuar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - aktualisht nuk ka indicie të tjera apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim tjetër të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”.

25. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht, verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;

- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtoare ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtoare, informatorë ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e saj për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUZIONE

26. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

27. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”,

Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR